



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.101/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi vlerësimin e procedurës dhe skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “4S” shpk nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF- 44294-11-20-2019 me objekt Loti III “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave te Mesme”, me fond limit/vlere te pritshme te kontrates 7.322.472 lekë pa tvsh.Shumatorja e çmimeve për njësi: 2553.4 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 06.01.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve te Shkollave te Mesme.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kadra” shpk nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

“4S” shpk
Lagja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Cajupi”, pranë shkollës “Liri Kazazi”, Lushnjë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Konvikteve te Shkollave te Mesme
Rruga “Jeronim De Rada”, tek ish Konvikti i Ekonomikut.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.11.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr.REF- 44294-11-20-2019 me objekt Loti III “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme”, me fond limit/vlere të pritshme të

kontrates 7.322.472 lekë pa tvsh. Shumatorja e çmimeve për njësi: 2553.4 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 06.01.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.

II.2. Në datën 06.01.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.01.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Dogel	5,247,450	I skualifikuar
- Kadra	5,709,740	I kualifikuar
- Nelsa	6,633,880	I skualifikuar
- 4S	7,311,600	I skualifikuar

II.4. Në datën 17.01.2020 operatori ekonomik "4S" shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Ne dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta per kualifikim, pika 2.3.5 e kapacitetit teknik kerkohet specifikisht sa me poshte: Operatori ekonomik te vertetoje se disponon Thertore te pajisur me: certificate pronesia, leje higjeno sanitare, Leje mjedisore Tipit C, License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore), certificate dezinfektimi 3D si dhe raport analizen mbi permbajtjen mikrobiologjike te ujit te perdorur ne therrtores ne momentin e hapjes se ofertave. Ne rastin kur operatori ekonomik ofertues e ka ne pronesi therrtores duhet te paraqesë Certifikatën e pronesisë së thertores dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa në rastin kur e ka me qera, duhet të paraqesë kontratën e qerasë, certifikaten e pronesisë dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa kur ka marrveshje bashkëpunimit duhet të paraqesë marrveshjen e bashkëpunimit të lidhur para noterit për të gjithë periudhën që kërkohet të furnizohet autoriteti kontraktor dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores . Marrveshja e bashkepunimi duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi. Certifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur nga shoqëria AB Gersa shpk per therrtores është e lëshuar më date 15.04.2019 dhe perseritja e trajtimit duhej bere ne 15.07.2019 pra operatori ekonomik nuk ka vertetuar nepermjet dokumentacionit te paraqitur qe ky proces eshte kryer nga operatori ekonomik ne daten 15.07.2019. Certifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur ne dokumentat e tenderit nuk eshte vlefshme ne daten e hapjes se procedures duke mos plotesuar piken 2.3.2 te kriterëve te vecanta per kualifikim kapaciteti teknik.*

- *Ne dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta per kualifikim, pika 2.3.9 e kapacitetit teknik kerkohet specifikisht sa me poshte: Operatori ekonomik te paraqese regjistrat e monitorimit te temperaturave per periudhen e vitit 2019 per Frigoriferët e instaluar në ambientet e ushtrimit te aktivitetit sipas Udhëzimit të Ministrisë të Bujqësisë Nr. 22 datë 25.11.2010 “Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operoret e biznesit ushqimor”. Operatori ekonomik “4 S” shpk ne plotesim te ketij kriteri nuk ka paraqitur regjistrat e monitorimit te temperaturave per frigoriferet per muajt korrik, gusht, shtator, tetor 2019 duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.9.*
- *Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertes se operatorit ekonomik “4 S” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

II.5. Në datën 23.01.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kadra” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Në përmbushje të pikës 2.3.5 mbi kapacitetin teknik kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AK. Kontratë Furnizimi me subjektin AB Gersa shpk, Certifikatë Pronësie të thertores, leje higjenosanitare, leje mjedisore tipi C, Licencë nga QKL me kodin II.1.A.1 thertore , certifikatë dezinfektimi 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në thertore. Në lidhje me pretendimin e KVO mbi vlefshmërinë e Certifikatës së dezinfektimit 3D sarojmë se certifikata është e vlefshme për një afat 1 vjecar nga data e lëshimit, njëlloj si të gjitha certifikatat e tjera të dezinfektimit të paraqitura në këtë procedurë prokurimi (Certifikatat e shoqërisë Delta Doni, Sinani Trading, 4S). Në certifikatën e sipërpërmendur në mënyrë absolute nuk përcaktohet se ajo skadon ose është e vlefshme deri më dt 15.07.2019, por se në këtë datë duhet bërë ripërtëritja e trajtimit sipas kontratës së lidhur midis thertores dhe shoqërisë dezinfektuese. Për paralelizëm sarojmë se në certifikatën e dezinfektimit Nr.serial 00013 lëshuar për shoqërinë 4S shpk përcaktohet se trajtimi duhet kryer cdo muaj sipas kontratës së lidhur por certifikata është e vlefshme për një afat 12 mujor.*
- *Në përmbushje të pikës 2.3.9 mbi kapacitetin teknik kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AK. Lidhur me pretendimin e KVO se nuk kemi paraqitur regjistrat e monitorimit të temperaturave për frigoriferët për muajt korrik, gusht, shtator, tetor 2019 duke mos plotësuar kriteret e vecanta për*

kualifikim , kapaciteti teknik pika 2.3.9 sqarojmë se kemi paraqitur regjistrat e kërkuar në një dokument të ngarkuar vecmas muajve të tjerë. Akoma më tej sqarojmë se në përmbushje të pikës 2.3.9 kemi paraqitur regjistrat edhe për shoqërinë furnizuese Sinani Trading shpk për të cilën kemi paraqitur kontratën e furnizimit, dokumentacionin e kërkuar për ambjentet frigoriferike të kësaj shoqërie si dhe regjistrat e monitorimit të temperaturave.

- Referuar klasifikimit të publikuar më datë 17.01.2020 KVO nuk e ka kryer vlerësimin e ofertave në bazë të shumatores së cmimeve për njësi por në bazë të vlerës së përgjithshme të ofertës e cila bie ndesh me kërkesat e dokumentave të tenderit të publikuara nga vetë AK (pasi sasisë janë referuese) si dhe me parimet e zhvillimit të procedurës Marrëveshje Kuadër.

- Operatori Kadra shpk i kualifikuar nga KVO nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit konkretisht:
 - ✓ Pikën 2.3.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon në stafin e tij një teknolog ushqimor dhe nuk vërteton se prodhuesi i produkteve blegtorale me të cilin ka marrëveshje bashkëpunimi të ketë të punësuar në stafin e tij një teknolog ushqimor. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ofretues duhet të ketë kontratë pune , diplomë, librezë shëndetësore, dhe të jetë i përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të vitit 2019 (muaji nëntor).
 - ✓ Pikën 2.3.3. të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon ambiente frigoriferike në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale të pajisur me licencë kodi II.1.B , leje higjensanitare , raport analizën e ujit, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe foto të ambjenteve të ushtrimit të aktivitetit. Referuar edhe ekstraktit të QKB ky operator ushtron aktivitet në vetëm një adresë për të cilin në lotin e parë shoqëria KADRA ka paraqitur dokumentacion për furrë të prodhimit të bukës dhe jo për magazinim të mallrave objekt prokurimi.
 - ✓ Pikën 2.3.4 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon në pronësi ose përdorim ose me kontratë bashkëpunimi Njësi prodhimi bukmeti në pronësi/përdorim sipas kontratës noteriale të pajisur me: certifikatë pronësie, leje higjensanitare, leje mjedisore e tipit C , licencë lëshuar nga AKB me kodin II.1.B, certifikatë dezinfektimi 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur nga njësitë e prodhimit të bulmetit të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.
 - ✓ Pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon në pronësi ose përdorim ose kontratë bashkëpunimi Thertore të pajisur me certifikatë pronësie ,leje higjensanitare, leje mjedisore tipi C,

licencë lëshuar nga QKL me kodin II.1.A 1 (thertore), certifikatë dezinfektimi 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në thertore në momentin e hapjes së ofertave.

- ✓ *Pikën 2.3.8 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale 2 mjete transporti ATV frigoriferik me dokumentacion të vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të vërtetuar me leje qarkullimi, siguracion, taksa të mjetit, leje e transportit që lëshohet nga Bashkia, kontrolli teknik i mjetit, leje higjenesanitare, dhe certifikatë pronësie.*

Sa më sipër kërkojmë:

Kualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria 4S.

Vlerësimin e ofertave në bazë të shumatores së cmimeve për njësi

Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria Kadra shpk.

II.6. Në datën 25.01.2020 me shkresën nr. 99 prot operatori ekonomik ankimues “4S” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me pranimin pjesërisht të ankesës nga autoriteti kontraktor, sa i takon arsyes së dytë të skualifikimit dhe mospranim për pjesën tjetër të ankesës.

II.7. Në datën 03.02.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.143 prot datë 10.02.2020 protokolluar me tonën me nr.134/2 prot datë 11.02.2020. me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “4S” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Ne dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta per kualifikim, pika 2.3.5 e kapacitetit teknik kerkohet specifikisht sa me poshte: Operatori ekonomik te vertetoje se disponon Thertore te pajisur me: certificate pronesie, leje higjeno sanitare, Leje mjedisore Tipit C, License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore), certificate dezinfektimi 3D si dhe raport analizen mbi permbajtjen mikrobiologjike te ujit te perdorur në therrtore në momentin e hapjes së ofertave. Në rastin kur operatori ekonomik ofertues e ka në pronësi therrtoren duhet të paraqesë Certifikatën e pronësisë së thertores dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në*

lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa në rastin kur e ka me qera, duhet të paraqesë kontratën e qerasë, certifikaten e pronesisë dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa kur ka marrveshje bashkëpunimit duhet të paraqesë marrveshjen e bashkëpunimit të lidhur para noterit për të gjithë periudhën që kërkohet të furnizohet autoriteti kontraktor dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores . Marreveshja e bashkëpunimi duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, ëbsite, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi. Certifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur nga shoqëria AB Gersa shpk per therrtore është e lëshuar më date 15.04.2019 dhe perseritja e trajtimit duhej bere ne 15.07.2019 pra operatori ekonomik nuk ka vertetuar nepermjet dokumentacionit te paraqitur qe ky proces eshte kryer nga operatori ekonomik ne daten 15.07.2019. Certifikata e dezinfektimit 3D e paraqitur ne dokumentat e tenderit nuk eshte vlefshme ne daten e hapjes se procedures duke mos plotesuar piken 2.3.2 te kriterëve te vecanta per kualifikim kapaciteti teknik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.3 *Operatori ekonomik te vertetoje se disponon Thertore te pajisur me: certificate pronesie, leje higjeno sanitare, Leje mjedisore Tipit C, License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore), certificate dezinfektimi 3D si dhe raport analizen mbi permbajtjen mikrobiologjike te ujit te perdorur në therrtore në momentin e hapjes se ofertave.*

Në rastin kur operatori ekonomik ofertues e ka në pronësi therrtoren duhet të paraqesë Çertifikatën e pronësisë së thertores dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa në rastin kur e ka me qera, duhet të paraqesë kontratën e qerasë, certifikaten e pronesisë dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores, ndërsa kur ka marrveshje bashkëpunimit duhet te paraqesë marrveshjen e bashkëpunimit të lidhur para noterit për të gjithë periudhën që kërkohet të furnizohet autoriteti kontraktor dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e therrtores . Marreveshja e bashkëpunimi duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, ëbsite, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues ”4S” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Furnizimi (Bashkëpunimi) Nr. 376 Rep Nr.286 Kol datë 12.02.2018 lidhur ndërmjet shoqëria ”AB-Gersa” shpk dhe shoqëria ”4S” shpk me objekt furnizimi nga pala e parë shoqëria AB- Gersa kundrejt palës së dytë shoqëria ”4S” shpk duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate me artikuj ushqimor: mish, nënprodukte të tij, shërbimin e therrjes etj sipas kërkesave dhe nevojave të shoqërisë 4S.
- Licencë me kod II.1.A.1 Therore për subjektin ”AB-Gersa” shpk.

- Licencë me kod II.3.C Tregëti me shumicë e kafshëve të gjalla për subjektin "AB Gersa" shpk.
- Licencë me kod III.1.B Leje mjedisore për veprimtarinë mbarështrim dhe therje kafshësh për subjektin AB-Gersa shpk.
- Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.1437
- Dëshmi Shërbimi DDD me përmbajtje si vijon: Firma Delete licensuar për shërbime Higjeno Sanitare DDD vërteton me kërkesë të institucionit Thertore AB -Gersa shpk ka kryer shërbimin më datë 15.04.2019. Shërbimi DDD. Përsëritja e trajtimit në datë 15.07.2019. Rekomandohet rikontroll një herë në tre muaj.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."* Aftësia teknike: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës"*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*

III.1.4. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të disponojnë Thertore te pajisur me: certificate pronësie, leje higjeno sanitare, Leje mjedisore Tipit C, License leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore), certificate dezinfektimi 3D si dhe raport analizen mbi përmbajtjen mikrobiologjike te ujit te perdorur në thertore në momentin e hapjes se ofertave.

Është përcaktuar gjithashtu se në rastin kur operatori ekonomik ofertues e ka në pronësi thertoren duhet të paraqesë Çertifikatën e pronësisë së thertores dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e thertores, ndërsa në rastin kur e ka me qera, duhet të paraqesë kontratën e qerasë, certifikaten e pronësisë dhe dokumentacionin e sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e thertores, ndërsa kur ka marrveshje bashkëpunimit duhet te paraqesë marrveshjen e bashkëpunimit të lidhur para noterit për të gjithë periudhën që kërkohet të furnizohet autoriteti kontraktor dhe dokumentacionin sipërpërmendur në lidhje me funksionimin e thertores. Marreveshja e bashkëpunimit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "4S" shpk për përmbushjen e këtij kriteri rezulton se thertorja diponohet me Kontratë Furnizimi (Bashkëpunimi) Nr. 376 Rep Nr.286 Kol datë 12.02.2018 lidhur ndërmjet shoqëria "AB-Gersa" shpk dhe shoqëria "4S" shpk me objekt furnizimi nga pala e parë shoqëria AB-Gersa kundrejt palës së dytë shoqëria "4S" shpk duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate me artikuj ushqimor: mish, nënprodukte të tij, shërbimin e therjes etj sipas kërkesave dhe nevojave të shoqërisë 4S. Gjithashu rezulton se është paraqitur Dëshmi Shërbimi DDD me përmbajtje si vijon: Firma Delete, licensuar për shërbime Higjeno Sanitare DDD, vërteton me kërkesë të institucionit Thertore AB -Gersa shpk ka kryer shërbimin më datë 15.04.2019. Shërbimi DDD. Përsëritja e trajtimit në datë 15.07.2019. Rekomandohet rikontroll një herë në tre muaj.

III.1.6. Referuar sa më sipër, argumentave të autoritetit kontraktor si dhe të palës ankimuese KPP konstaton se certifikata e dezinfektimit, dezinfektim, deratizimit, e disponuar nga subjekti furnizues AB Gersa shpk ka një afat të përcaktuar për rikontroll nga subjekti i licesuar përkatësiht datën 15.07.2019. Po ashtu në këtë certifikatë është rekomanduar rikontroll një herë në tre muaj. KPP gjykon se ankimuesi kishte detyrimin të paraqeste në procedurën e prokurimit objekt ankimi dëshminë/certifikatën e rifreskuar brenda tre muaj nga subjekti i licensuar në mënyrë që të konsiderohej e vlefshme dhe për të krijuar bindjen tek autoriteti kontraktor se gjendja aktuale e theretores është e përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me të gjitha përcaktimet ligjore lidhur me dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin e ambjentëve. KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi provon vetëm faktin se autoriteti licensues ka urdhëruar për një rikontroll në datën 15.07.2019 por mbetet tërësisht e dyshimtë nëse është bërë ky rikontroll dhe po aq të paqarta mbeten konstatimet që kanë dalë nga rikontrolli nëse është bërë një i tillë. Akoma më tej KPP gjykon se pretendimi i ankimuesit për vlefshmërinë një vjecare të certifikatës nuk provohet në rastin konkret pasi certifikata nuk e parashikon shprehimisht një afat të tillë dhe për më tepër në fund të certifikatës është rekomanduar rikontroll një here në tre muaj, cka provohet fakti se subjektit i është përcaktuar një afat tre mujor për rikontroll dhe jo një vjekar sikundër pretendon ankimuesi.

Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSh", i ndryshuar, parashikohet se: *"Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj"*.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës (barra e provës i bie kërkuetit), pra është barrë e operatorit ekonomik ankimues që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij lidhur me mosparaqitjen e rinovuar të certifikatës së këkruar në kriterin e vecantë të kualifikimit.

III.1.7. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet

ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga "4S" sh.p.k. nuk është i vlefshëm dhe si rrjedhojë skualifikimi i tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi është i drejtë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "4S" shpk Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" (i ndryshuar), me titull "*Të drejtat e personit të interesuar*" parashikon se: "*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin*".

III.2.1. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për rrjedhojë, ky pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “4S” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me nr.REF- 44294-11-20-2019 me objekt Loti III “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave te Mesme”, me fond limit/vlere te pritshme te kontrates 7.322.472 lekë pa tvsh.Shumatorja e çmimeve për njësi: 2553.4 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 06.01.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve te Shkollave te Mesme.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.134 Protokoli; Datë 03.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha